



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN - DEGA E GJYKATËS VITI

Numri i lëndës: 2021:209372

Datë: 04.03.2024

Numri i dokumentit: 05407932

**P.nr.326/2021**

## **NË EMËR TË POPULLIT**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Dega në Viti, Departamenti i Përgjithshëm** përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Naser Maliqi, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Shqipe Kastrati, në çështjen penale kundër të pandehurit Sh.M, nga Vitia, për shkak të veprës penale kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, PP.II.nr.1187/2021 të datës 31.08.2021 pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në të cilin kanë prezantuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu, dhe i pandehuri i lartcekur, me datë 29.02.2024 mori dhe publikisht shpalli ndërsa me datë 04.03.2024 përpiloi këtë:

## **AKTGJYKIM**

**I pandehuri Sh.M**, nga babai M, dhe nëna H, e lindur B, i lindur me datën .... në fshatin ....., Komuna e Vitisë, me vendbanim në Viti, rruga....., ka të kryer katër vjet të shkollës fillore, punon punë bujqësore, i martuar, baba i pesë fëmijëve, i gjendjes së mesme ekonomike, me numër personal identifikues ..... shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

## **ËSHTË FAJTOR**

Sepse me datë 26.08.2021 rreth orës 14:30 në fshatin....., Komuna e Vitisë, patrulla e policisë kufitare për kontroll ka ndaluar automjetin kombi e markës "Iveco", ngjyrë e zezë, me tabela....., që e drejtonte i pandehuri i cili në kombi kishte të ngarkuar rreth 2.5 metër kub dru, të llojit të "Ahut", pa dokumentacion përkatës-damkosje dhe pa dokumente përcjellëse të cilat dru në Republikën e Kosovës janë futur rrugëve ilegale nga fshati....., Republika e Maqedonisë së Veriut, në këtë mënyrë i pandehuri me veprimet e tij ka bërë bartjen e mallit përmes rrugëve ilegale-malore, e që shuma e detyrimeve doganore sipas vlerësimit të doganës është 14 euro e 9 cent.

-me çka ka kryer veprën penale kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK,

-Andaj në bazë të nenit 4, 38, 39,40, 42, 47, 48, 49, 69,70,71 dhe 72 të KPRK-se dhe nenit 364, 449 te KPPK-se,

## **E GJYKON**

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej 3 (tre) muaj i cili dënim nuk do të ekzekutohen nëse i pandehuri në periudhën verifikuese prej 1 (një) viti nuk kryen ndonjë veprë tjetër penale nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Në bazë të nenit 311 paragrafi 6 i KPRK-ës nga i pandehuri konfiskohet malli i kontrabanduar.

**Detyrohet** i pandehuri që në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej 20 € (njëzet euro), ndërsa ne emër të viktimave të krimit shumen prej 30 € (tridhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

## **ARSYETIM**

### 1.Rrjedha e çështjes dhe fjala përfundimtare

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, me data 31.08.2021 ka ngritur aktakuzën me numër PP.II.nr.1187/2021, kundër të pandehurit Sh.M, nga Vitia, për shkak të veprës penale kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK.

Më datë 23.03.2022 në këtë gjykatë është mbajtur seanca e shqyrtimit fillestar në të cilën kanë prezantuar prokurori i shtetit dhe i pandehuri Sh.M, në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe nuk e pranon fajësinë për kryerjen e saj, me ç' rast gjyqtari i vetëm gjykues konform nenit 243 dhe 244 të KPP, e ka njoftuar të pandehurin se mund të paraqesin kundërshtimet e tyre për provat e cekura në aktakuzë dhe të paraqesin kërkesë për hudhjen e aktakuzës.

Me krijimin e kushteve ligjore gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit gjyqësor me datën 29.02.2024 në të cilën kanë prezantuar prokurorja e shtetit Kujtesa Fazliu dhe i pandehuri Sh.M, në këtë seancë pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit i pandehuri ka deklaruar se e ka kuptuar plotësisht aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen e saj me ç' rast gjykata pas dëgjimit të palëve dhe në pajtim me nenin 322 të KPP-ës ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë nga ana e të pandehurit.

Dhe në këtë seancë pasi që i pandehuri i lartcekur e ka pranuar fajësinë për veprën penale për të cilën është akuzuar gjykata nuk e ka bërë administrimin e provave personale dhe materiale dhe palët kanë dhënë fjalët e tyre përfundimtare.

Prokurorja e shtetit në fjalën përfundimtare ka deklaruar se nuk e kundërshton pranimin e fajësisë.

I pandehuri i lartcekur në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i vjen keq për rastin që ka ndodhur dhe ka premtuar që në të ardhmen nuk do të bie ndesh me ligjin dhe nuk do të përsëris veprën penale.

## 2.Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Gjykata në seancën e shqyrtimit gjyqësor pas dëgjimit të palëve ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurit për veprën penale për të cilën akuzohet ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë si në kuptim të nenit 322 paragrafi 1 të KPP-së dhe se pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit nuk është kundërshtuar nga ana e palëve prezente. Në këtë aspekt gjykata ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga ana e të pandehurit, se i pandehuri nuk ka qenë i detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështetet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza siç janë: kallëzimi penal me numër 2021-YEB-058 i datës 27.08.2021, deklarata e të pandehurit, raporti i vlerësimit nga Dogana e Kosovës, kërkesa për sekuestrimin e përkohshëm të mallit, fotokopjet e letërnjoftimit dhe certifikatës së regjistrimit të automjetit në emër të të pandehurit, foto dokumentacioni, raporti i policit B.S, të dhënat nga data baza e policisë për të pandehurin, si dhe shkresat e tjera në lëndë. Po ashtu me rastin e pranimit të fajësisë nga ana e të pandehurit gjykata gjeti se aktakuza lëndore nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

## 3.Gjendja faktike e vërtetuar

Duke u bazuar në të lartcekurat gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike: i pandehuri i lartcekur e ka kryer veprën penale kontrabandimi i mallrave, nga neni 311 paragrafi 2 të KPRK, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

## 4. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata me rastin e matjes së dënimit ka vlerësuar që të pandehurit duhet ti shqiptohet dënimi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi ngase duke i marrë parasysh të gjitha rrethanat dhe provat të cilat gjinden në shkresat e lëndës, ky dënim do të jetë i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale, sjelljen dhe rrethanat e kryesit si dhe përgjegjësinë penale të tij, gjykata me rastin e matjes së dënimit pati parasysh rregullat e përgjithshme për matjen e dënimit si në kuptim të nenit 69 të KPRK-ës ashtu që gjykata mori parasysh shkallën e përgjegjësisë penale të kryesit e cila nga provat materiale në shkresat e lëndës del të jetë e lartë meqenëse i pandehuri me rastin e kryerjes së veprës penale ka qenë i përgjegjshëm për veprimet e tija dhe veprën penale e ka kryer me dashje dhe atë direkte, po ashtu me rastin e caktimit të dënimit gjykata pati parasysh pranimin e fajit nga ana e të pandehurit si dhe rrethanat personale të kryesit.

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh edhe rregullat e përgjithshme të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërsimin e dënimit si në kuptim të nenit 70 të KPRK-ës ashtu që si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori faktin se i njëjti ka pranuar fajësinë për veprën penale e cilat i vihet në barrë, i njëjti është penduar dhe ka shfaqur keqardhje për veprimet e tija, po ashtu si rrethanë lehtësuese për të pandehurin gjykata mori edhe premtimin e tij se në të ardhmen nuk do të kryej vepra të tilla, ndërsa rrethanë rënduese për të pandehurin gjykata mori shkallën e lartë të dashjes të shfaqur nga ana e kryesit meqenëse nga shkresat e lëndës del se i pandehuri këtë vepër e ka kryer me dashje, andaj duke u bazuar në të lartcekurat dhe në kuptim të nenit 71 paragrafi 1 nën paragrafi 1.3 të KPRK-ës gjykata të pandehurit i shqiptoj dënimin brenda kufijve të paraparë ligjor gjithnjë duke konsideruar se me dënimet e shqiptuara ndaj të pandehurit mund të arrihen qëllimet e dënimit si në kuptim të nenit 38 të KPRK-ës të cilat konsistojnë në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale dhe rehabilitimin e tyre, parandalimin e personave të tjerë nga kryerja e veprave penale, shprehjen e gjykimit shoqëror për veprat penale dhe ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

#### 6.Vendimi mbi konfiskimin

Gjykata në bazë të nenit 311 paragrafi 6 i KPRK-ës ka vendosur që të pandehurit ti konfiskohet malli i kontrabanduar.

#### 7.Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale

Gjyqtari i vetëm gjykues ka detyruar të pandehurin që kësaj gjykate në emër të paushallit gjyqësor t'ia paguaj shumën prej 20 € (njëzet euro), ndërsa në emër të viktimave të krimit shumen prej 30 € (tridhjetë) euro si dhe shpenzimet e procedurës gjyqësore sipas llogarisë përfundimtare.

Andaj duke u bazuar në të lartcekura gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

### **GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-DEGA NË VITI**

#### **Departamenti i Përgjithshëm**

P.nr.326/2021, me datë 04.03.2024

**Bashkëpunëtorja profesionale,**  
Shqipe Kastrati

**Gjyqtari i vetëm gjykues,**  
Naser Maliqi

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit të të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet Gjykatës Themelore në Gjilan.